



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 37, datë 21.05.2024

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT
TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2023**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Udhëzimit të Minsitrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e “Raportit mbi monitorimin e zbatimit të buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023”, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen të gjitha Drejtoritë, Njësitë Administrative, Ndërmarrjet dhe Insitucionet e Bashkisë Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 22.05.2024

**RAPORT MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT TË
DURRËS PËR VITIN 2023**

Mars 2024



Përmbajtja

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM	3
I. Shpenzimet sipas burimit të financimit	5
I.1 Shpenzimet nga të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtezuar dhe sektoriale.....	5
I.2 Shpenzimet nga Fondi i Rindërtimit.....	7
I.3 Shpenzimet nga transfertat e kushtëzuar	8
II. Informacion mbi volumin dhe madhësinë e ndryshimit të buxhetit nga të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar dhe sektoriale	10
III. Karakteristika kryesore të performancës së shpenzimeve	14
Shpenzimet korrente.....	16
Shpenzimet kapitale.....	18
IV. Vetëvlerësimi financiar	20
V. Treguesit financiar (te lexoj tek udhëzimi si janë normat)	23
Shtojca 1: Fondi i rindërtimit nga buxheti i shtetit	25
Shtojca 2 : Realizimi i të ardhurave të veta për vitin 2023	48
Aneksi 1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"	56
Aneksi 2 "Raporti i shpenzimeve të programeve sipas artikulave"	58
Aneksi 5 "Projektet e investimeve me financim të brendshëm"	60



VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Bashkia Durrës për vitin 2023 në mbështetje të ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ka miratuar buxhetin të ndarë në 20 programe buxhetore. Plani fillestar i buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023 i miratuar me VKB nr.150, datë 22.12.2023 ishte 3,945,205 mijë lekë. Në bazë të Vendimeve të veçanta të Këshillit Bashkiak buxheti u shtua në vlerën 734,541 mijë lekë. Këto shtesa përbëhen nga fondet e trashëguara nga viti i mëparshëm 2022 në vlerën 564,877 mijë lekë, si dhe nga transfertat e pakushtëzuar dhe sektoriale që janë alokuar gjatë vitit në vlerën 169,665 mijë lekë.

Buxheti i Bashkisë Durrës për vitin 2023 me të gjitha rialokimet e bëra kapi vlerën 4,679,747 mijë lekë. Po të shtojmë edhe transfertat e kushëzuara (fondet e Ministrive të Linjës) që u alokuan gjatë vitit, si dhe fondet e rindërtimit, buxheti total i Bashkisë Durrës për vitin 2023 kapi vlerën 10,712,531 mijë lekë.

Për vitin 2023 të ardhurat e përgjithshme faktike janë 10,445,112 mijë lekë.

Të ardhurat e përgjithshme faktike nga gjitha burimet e financimit (të ardhurat e veta, transfertat e pakushtëzuara, transfertat sektoriale, transfertat e kushtëzuara, fondet e rindërtimit, si dhe fondet e trashëguara nga viti paraardhës) në fund të vitit 2023 rezultojnë 10,445,112 mijë lekë. Krahasuar me vitin 2022 janë 9% më pak. Kjo ulje vjen si rezultat i pakësimit të fondeve të alokuara në kuadër të procesit të rindërtimit, si nga Fondi i Rindërtimit i buxhetit të shtetit, ashtu dhe nga fondet për subvencionimin e qerasë së familjeve të dëmtuara nga tërmeti.

Të ardhurat të ndara sipas burimit të financimit paraqiten në tabelën e mëposhtëme:

Tabela 1: Të ardhurat sipas burimit për vitet 2022-2023 (në 000/lekë)


NR.	EMERTIMI TË ARDHURAVE	Fakt 2022 000/leke	Fakt 2023 000/leke	Ndryshimi ne %
A	TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA (A1+A2+A3+A4)	1,515,885	1,851,571	22
A.1	Të ardhura nga taksat lokale	646,621	816,647	26
A.2	Të ardhura nga taksat e ndara	300,269	310,670	3.5
A.3	Të ardhura nga tarifat vendore	484,007	594,721	23
A.4	Të ardhura te tjera	84,988	129,533	52
B	TRANSFERTA NGA BUXHETI QENDROR (B1+B2+B3)	8,114,742	7,021,490	-13
B.1	Transferta e pakushtëzuar	877,905	1,206,215	37
B.2	Trasferta e pakushtëzuar sektoriale	697,537	689,665	-1
B.3	Transferta e kushtëzuar (Ministrinë e linjës)	2,215,869	1,526,845	-31
B.4	Fondi i rindërtimit	4,323,431	3,598,765	-20
C	HUAMARRJA (C1+C2)	-	-	-
C.1	Huamarrja afatshkurtër			
C.2	Huamarrja afatgjatë			



D	TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR (D1+D2)	856,804	1,572,051	-13
D.1	Trashëgimi pa destinacion	749,339	593,805	-21
D.2	Trashëgimi me destinacion	107,465	71,072	-34
D.3	Trashëgimi nga fondi rindërtimit	945,189	907,174	-4
TOTALI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË (A+B+C+D)		11,432,620	10,445,112	-9

Të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit 2023, pa përfshirë fondet e trashëguara nga viti 2022, kapën vlerën 8,873,061 mijë lekë dhe pesha specifike e tyre paraqitet si në grafikun e mëposhtëm.

TE ARDHURAT E ARKETUARA VITI 2023



Të ardhurat nga burimet e veta të Bashkisë për vitin 2023 janë 1,851,571 mijë lekë, me një realizim 87%. Në shtojcën 2 është paraqitur në mënyrë të detajuar realizimi i të ardhurave të veta të Bashkisë Durrës për vitin 2023.

Për vitin 2023 shpenzimet e përgjithshme faktike janë 7,688,484 mijë lekë.

Për vitin 2023 shpenzimet e përgjithshme faktike të Bashkisë Durrës nga të gjitha burimet e financimit, duke përfshirë edhe fondet e Ministrive të Linjës, si dhe fondet e rindërtimit nga buxheti i shtetit kapën vlerën 7,688,484 mijë lekë. Sipas burimit të financimit shpenzimet e përgjithshme të Bashkisë Durrës për vitin 2023 janë:



Tabela 2 : Shpenzimet faktike për vitin 2023 në 000/lekë

Emërtimi shpenzimit	Totali	Burimi i Financimit				
		Të ardhurat e veta (grup 00-kapitull 5)	Transferrat e pakushtezuar dhe sektoriale (grup 00-kapitull 1)	Të ardhura jashte limit (grup 00-Kapitull 6)	Fondet e rindërtimit	Transferrat e kushtezuara (Ministri linje, FZHR etj)
shpenzime personeli	1,503,939	351,655	1,117,969			34,315
shpenzime te tjera korrente	2,715,814	551,030	683,893	30	72,835	1,408,026
shpenzime kapitale	3,468,738	834,060	8,509		2,619,364	6,805
Totali	7,688,484	1,736,745	1,810,371	30	2,692,199	1,449,146
<i>Burimi i financimit në %</i>		22.6%	23.5%		35.0%	18.8%

Sikurse shihet nga tabela për vitin 2023 shpenzimet me fondin e rindërtimit zënë peshën më të madhe në buxhet me 35%. Sipas natyrës ekonomike shpenzimet me volum më të madh janë shpenzimet kapitale me 45%, mbas tyre vijnë shpenzimet e tjera korrente me 35% dhe pastaj ato të personelit me 20%.

I. SHPENZIMET SIPAS BURIMIT TË FINANCIMIT

I.1 Shpenzimet nga të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtezuar dhe sektoriale

Shpenzimet faktike të Bashkisë Durrës për vitin 2023 me burim financimi të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtezuar dhe sektoriale rezultojnë 3,547, 116 mijë lekë dhe paraqiten si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 3: Shpenzimet totale te grupit 00 sipas artikujve dhe burimeve të financimit, viti 2023 (në 000/lekë)

Grup	Llog.ekon	Totali		Transferta e pakushtezuar		Transferta specifike		Të ardhurat	
		Plan	Fakt	Kapitull 1		Kapitull 1		Kapitull 5	
				Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
00	600-paga	1,352,504	1,260,254	648,947	609,963	391,696	353,034	311,861	297,258
00	601-sigurime	224,873	209,370	108,973	99,410	59,215	55,562	56,686	54,398
00	602-Shp.operative	1,280,883	1,118,006	471,955	366,610	307,118	302,385	501,809	449,010
00	603-subvencione	-	-	-	-	-	-	-	-
00	604- transfertat te brendshme	40,000	40,000	-	-	-	-	40,000	40,000
00	606-transferime tek individet	86,285	76,917	14,108	13,719	1,208	1,178	70,969	62,020
	Shp. korrente	2,984,546	2,704,547	1,243,984	1,089,703	759,237	712,159	981,325	902,685



00	230- kapitale patrupëzuara	25,095	24,756	6,600	6,600	-	-	18,495	18,156
00	231-kapitale trupëzuara	1,030,474	817,813	40,117	1,781	1,500	128	988,857	815,904
	Shp. kapitale	1,055,570	842,569	46,717	8,381	1,500	128	1,007,352	834,060
00	Total	4,040,115	3,547,116	1,290,701	1,098,084	760,737	712,287	1,988,677	1,736,745

Tabela 4 : Shpenzimet faktike të grupit 00 sipas artikujve, viti 2022-2023 (në 000/lekë)

Grupi	LLOG. EKON.	Viti 2022		Viti 2023		Ndryshimi në %
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	
00	600 (paga)	1,209,695	1,099,610	1,352,504	1,260,254	15
00	601(sigurime)	198,551	183,069	224,873	209,370	14
00	602 (shp.operative)	1,305,567	1,248,926	1,280,883	1,118,006	-10
00	603(subvencione)	-	-	-	-	
00	604 (transfera te brendshme)	40,000	40,000	40,000	40,000	0
00	606 (transfera per buxh. individe)	67,726	66,780	86,285	76,917	15
00	Shp.korrente	2,821,539	2,638,385	2,984,546	2,704,547	3
00	230 (kapitale të patrupëzuara)	31,482	14,699	25,095	24,756	68
00	231(kapitale të trupëzuara)	976,177	631,016	1,030,474	817,813	30
	Shp. kapitale	1,007,659	645,715	1,055,570	842,569	30
	Total	3,829,198	3,284,100	4,040,115	3,547,116	8

Shpenzimet faktike nga të ardhurat dhe tranferta e pakushtëzuar dhe sektorialet për vitin 2023, krahasuar me vitin 2022 janë rritur me 263,016 mijë lekë ose 8%. Rritjen më të madhe e kanë patur investimet me 30% . Rritje kanë pësuar edhe shpenzimet e personelit për arsye të rritjes së nivelit të pagave për të gjithë punonjësit e Bashkisë dhe ndërmarrjeve dhe institucioneve të varësisë.

Buxheti nga të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuara dhe sektoriale për vitin 2023 ishte 4,679,747 mijë lekë, plan thesari ishin 4,040,115 mijë lekë, kurse shpenzimet faktike 3,547,116 mijë lekë . Në mënyrë më të detajuar buxheti i rishikuar për çdo program buxhetor paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 5: Shpenzimet totale për cdo program, grupi 00 viti 2023 (në 000/lekë)

Gr.	Prog ram	Titulli	Plan i Rishikuar Viti 2023	Plan i Periudhës/ progresiv i 4 mujorit	Fakt
1	00	01110 Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	644,386	637,886	494,937
2	00	03140 Shërbimet e Policisë Vendore	82,214	81,774	75,694

3	00	03280	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	149,336	112,937	65,892
4	00	04130	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	19,811	7,329	919
5	00	04220	Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorëve	4,948	0	0
6	00	04240	Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit	109,969	97,969	95,425
7	00	04260	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	5,856	5,856	2,615
8	00	04520	Rrjeti rrugor	592,903	509,446	387,723
9	00	04570	Transporti Publik	0	0	0
10	00	05100	Menaxhimi Mbetjeve	1,026,735	1,012,196	965,717
11	00	06140	Planifikimi Urban Vendor	53,940	38,798	17,100
12	00	06260	Shërbimet Publike Vendore	489,649	438,002	401,715
13	00	06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	0	0	0
14	00	07220	Shërbimet e Kujdesit Parësor	16,048	16,048	11,387
15	00	08130	Sport dhe Argëtim	152,803	137,624	121,973
16	00	08220	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore	78,067	74,829	71,181
17	00	09120	Arsimi Bazë Përfshirë Parashkollorin	769,184	541,542	566,002
18	00	09230	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	131,820	126,673	102,142
19	00	10430	Përkujdesja Sociale	149,278	144,527	130,742
20	00	10661	Strehimi Social	162,800	56,740	35,952
	00			4,639,747	4,040,115	3,547,116
	00		Fondi rezervë	25,000		
	00		Fondi kontigjencës	15,000		
	00		TOTALI	4,679,747	4,040,115	3,547,116

Shënim: Këtu nuk janë përfshirë shpenzimet me fonde nga transferta e kushtëzuar, FZHR, si dhe nga Fondi i Rindërtimit i buxhetit të shtetit.

I.2 Shpenzimet nga Fondi i Rindërtimit

Në periudhën 1 Janar -31 Dhjetor Bashkia Durrës ka përfituar fonde në formën e transfertës së pakushtëzuar nga fondet e Rindërtimit të buxhetit të shtetit 2023 me një vlerë totale prej 3,598,765 mijë lekë për financimin e mëtejshëm të projekteve në proces. Në bazë të vendimeve të Këshillit Bashkiak është bërë detajimi i këtyre fondeve pa ndryshuar destinacionin për të cilin janë alokuar. Po të shtojmë edhe fondet e trashëguara nga viti paraardhës 2022 fondet e Rindërtimit kapi vlerën 4,505,939 lekë. Nga këto u disbursuan 2,692,191 mijë lekë. Fondet e papërdorura prej 1,813,748 trashëgohen në vitin 2024 me të njëjtin destinacion. Fondet e Rindërtimit për vitin 2023 paraqiten si më tabelën e mëposhtme:



Tabela 6 : Fondet e rindërtimit sipas artikujve, viti 2023 (në 000/lekë)

Llogaria Ekonomike	kapitull	Fonde të trashëguara nga 2022 per rindertimin	Fonde rindërtimi të alokuara në 2023	Plan 2023	Fakt 2023
1	2	3	4	5=3+4	6
230	Kap.1	7,503		7,503	-
231	Kap.1	818,145	3,598,765	4,416,910	2,619,364
602	Kap.1	2,348		2,348	
604	Kap.1	6,336		6,336	1,250
606	Kap.1	56,932		56,932	56,560
total	Kap.1	891,264	3,598,765	4,490,029	2,677,174
604	Kap.6	15,485		15,485	14,600
606	Kap.6	425		425	425
total	Kap.6	15,910	-	15,910	15,025
TOTALI Kap.1+ kap.6		907,174	3,598,765	4,505,939	2,692,199

Në mënyrë të detajuar fondi i Rindërtimit që i është alokuar Bashkisë Durrës jepet në shtojcën 1: Fondi i Rindërtimit nga buxheti i shtetit.

I.3 Shpenzimet nga transferta e kushtëzuar

Gjatë vitit 2023 Bashkia Durrës përfitoi fonde nga Ministrinë e Linjës për financimin e funksioneve të deleguara . Këto fonde janë me destinacion dhe përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë alokuar. Totali i këtyre fondeve të alokuara gjatë vitit 2023 kapi vlerën 1,526,845 mijë lekë. Nga këto u shpenzuan 1,449,147 mijë lekë. Fondet e papërdorura nga transferta e kushtëzuar gjatë vitit 2023 nuk mbarten për vitin pasardhës. Në mënyrë të detajuar ato paraqiten si më poshtë:

Tabela 7 : Transferta e kushtëzuar (fondet e Ministrive të linjës) viti 2023, në 000/lekë

Emërtimi produktit	Njesia shpenzuese	Grupi	Programi	Kap.	Plani	Fakti
Subvencioni i qerasë për familjet e dëmtuara nga tërmeti	Bashkia Durrës	10	06190	1	166,500	163,150
Subvencioni i qerases për familjet në nevojë	Bashkia Durrës	10	06190	1	15,152	15,152
Subvencion familjeve nga Enti banesave	Bashkia Durrës	10	06190	1	3,028	3,028
Q.K.B	Bashkia Durrës	10	04130		136	96



TVSH per pajisjet e shkolles se Mesme Bashkuar+ kopshti Ismet Nanushi (projekti EU4SCHOOLS)	Bashkia Durrës	11	09120	4	3,337	1,399
Pagesa PAK	Bashkia Durrës	13	10430	1	36,224	35,629
Ndihma ekonomike	Bashkia Durrës	13	10430	1	1,137,409	1,094,531
Vendime gjyqore PAK	Bashkia Durrës	13	10430	1	1,890	1,867
Gjendja Civile	Bashkia Durrës	16	01170	1	25,910	21,568
Shperblimi zjarfikesve	Bashkia Durrës	17	10910	1	2,890	2,457
Perforcim terreni nga rreshqitja ne zonen e NJA nr.2, nr.4, Ishem (VKM nr.260 dt.27.04.2023)	Bashkia Durrës	17	10910	1	7,987	0
Shtetas te ndihmuar banesat e te cileve jane demtuar nga fatkeqesi te ndryshme (fondi i kushtezuar i mbrojtjes civile	Bashkia Durrës	17	10910	1	38,975	28,504
Pagesa e njoftimit te zgjedhesve per zgjedhjet e 14 Majit	Bashkia Durrës	73	01620	1	13,583	11,575
Projekti "Ngritja e Qendres Rinore Multifunkionale"	Bashkia Durrës	87	08610	1	9,000	5,407
TOTALI 1					1,462,020	1,384,362
Ativitetete të fushës së trashëgimisë jomateriale (Festivali folklorik i Gjirokastres)	Qendra Kulturore "A.Moisiu"	12	08220	1	400	400
Fëmijë në nevojë që përfitojnë nga shërbimi arsimor	Qendra ekonomike e Arsimit	11	09120	1	36,173	36,173
Fëmijë në nevojë që përfitojnë nga shërbimi arsimor	Qendra ekonomike e Arsimit	11	09230	1	2,763	2,763
Bursa të përfiturra nga nxënësit e arsimit profesional	Qendra ekonomike e Arsimit	10	09240	1	21,953	21,947
Fondi social (Qendra shërbimeve mbrojtë fëmijë dhe familjen - Shkozet)	Qendra ditore te Moshuarve	13	10430	1	3,537	3,503
TOTALI 2					64,825	64,785
TOTALI 1+2					1,526,845	1,449,147

Transferta e kushtëzuar sipas natyres ekonomike krahasuar me vitin 2022 është sipas tabelës së mëposhtëme:



Tabela 8: Transferta e kushtezuar 2022-2023 (000/lekë)

Grupi	Llogaria ekonomike	Viti 2022		Viti 2023		Ndryshimi në % i faktit
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	
00	600 (paga)	28,319	27,394	36,490	31,601	15
00	601(sigurime)	3,150	2,862	3,478	2,714	-5
00	602 (shp.operative)	25,112	24,475	45,488	44,318	81
00	603(subvencione)	-	-	-	-	-
00	604 (transferta te brendshme)	9,668	9,668	38,975	28,504	195
00	606 (transferta per buxh. individe)	2,145,070	2,043,730	1,382,090	1,335,204	-35
00	Shp.korrente	2,211,319	2,108,128	1,506,522	1,442,342	-32
00	230 (kapitale të patrupëzuara)			-	-	-
00	231(kapitale të trupëzuara)	4,550	4,492	20,324	6,805	51
	Shp. kapitale	4,550	4,492	20,324	6,805	51
	Total	2,215,869	2,112,621	1,526,845	1,449,147	-31

Sikurse shihet nga tabela fondet e alokuara nga Ministrinë e Linjes për vitin 2023 janë 689,024 mijë lekë më pak , kjo sepse gjatë vitit 2023 fondet për subvencionimin e qerave së familjeve të dëmtuara nga tërmeti ishin vetëm 166,500 mijë lekë, nga 979 milion që u alokuan për vitin 2022.

II. INFORMACION MBI VOLUMIN DHE MADHËSINË E NDRYSHIMIT TË BUXHETIT NGA TË ARDHURAT E VETA DHE TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR DHE SEKTORIALE

Në tabelën e mëposhtme po paraqesim si ka ndryshuar buxheti për grupin 00 (pa fondin e rindërtimit) gjatë vitit 2023 .

Tabela 9: Ndryshimet e buxhetit për cdo program, viti 2023 (ne 000/lekë)

Gr.	Emërtimi	Titulli	Plan Fillestar Viti 2023 (miratuar me VKB nr.150 dt.20.12.2022)	Fondet e trashëguara nga viti 2022(miratuar me VKB nr.86 dt.30.03.2023)	Rialokimet gjate vitit	Plan i Rishikuar (progresivi) Viti 2023	Ndryshimet ne vlerë	Ndryshimi ne %
			2	3	4	5=2+3+4	6=5-2	7=6/2
00	Programi 1	01110	454,671	54,089	135,625	644,385	189,714	42
00	Programi 2	03140	79,413	0	2,801	82,214	2,801	4
00	Programi 3	03280	92,527	55,024	1,786	149,337	56,810	61
00	Programi 4	04130	14,811	5,000		19,811		
00	Programi 5	04220	30,000	0	(25,052)			

00	Programi 6	04240	67,574	39,295	3,100	109,969	42,395	63
00	Programi 7	04260	3,461	2,203	192	5,856	2,395	69
00	Programi 8	04520	425,900	141,301	25,702	592,903	167,003	39
00	Programi 9	04570	0	0		0		42
00	Programi 10	05100	961,564	63,311	1,860	1,026,735	65,171	7
00	Programi 11	06140	53,245	0	695	53,940	695	1
00	Programi 12	06260	389,399	98,910	1,341	489,650	100,251	26
00	Programi 13	06370	0	0		0	0	
00	Programi 14	07220	0	16,048		16,048	16,048	
00	Programi 15	08130	129,786	22,155	862	152,803	23,017	18
00	Programi 16	08220	71,150	4,347	2,570	78,067	6,917	10
00	Programi 17	09120	703,979	52,743	12,462	769,184	65,205	9
00	Programi 18	09230	123,642	6,642	1,536	131,820	8,178	7
00	Programi 19	10430	141,283	3,810	4,185	149,278	7,995	6
00	Programi 20	10661	162,800	0		162,800	0	-
			3,905,205	564,877	169,665	4,639,747	734,542	19
	Fondi reserve		25,000			25,000		
	Fondi kontigjences		15,000			15,000		
	TOTALI		3,945,205	564,877	169,665	4,679,747	734,542	19%

Buxheti i Bashkisë Durrës (grupi 00) për vitin 2023 së bashku me fondet e trashëguara nga viti 2022 prej 564,877 mijë lekë kapi vlerën 4,510,082 mijë lekë. Gjithashtu gjatë vitit pati nga buxheti i shtetit alokime fondesh me një vlerë totale 169,665 mijë lekë. Duke përfshirë edhe këto alokime buxheti i Bashkisë Durrës për vitin 2023, nga burimet e veta dhe transferta e pakushtezuara dhe sektoriale ishte 4,679,747 mijë lekë, pra rezultoi që gjatë vitit të jetë shtuar 19 %.

Shtesa apo rishpërndarjet e fondeve ndërmjet programeve buxhetore në grupin 00 janë miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak dhe janë 3 raste si më poshtë :

Tabela 10: Alokimet dhe rialokimet e fondeve viti 2023(në 000/lekë)

Nr.	Gr.	Struktura buxhetore	Llog.ekon.	Kap	Shtesa	Pakësime	Totali ndryshimeve	Emërtimi i fondit	Nr. dhe Data vendimit
1	00	04220	231	5	0	-25,052	-25,052	Fondi është mar nga investime të ndryshme dhe është alokuar për financimin e shpenzimeve për shpronisime të pronave private që preken nga investimi publik me objekt "Rikonstruksion rruga Apulia paraqet me linjen	Nr.163 Dt.03.11.2023
	00	04520	231	5	0	-5,048	-5,048		
	00	04520	231	5	0	-88	-88		
	00	06260	231	5	0	-400	-400		
	00	06260	231	5	0	-360	-360		
	00	04520	231	5	21,412	0	21,412		
	00	01110	602	5	1,500	0	1,500		
	00	04240	231	5	2,140	0	2,140		
00	04520	602	5	5,896	0	5,896			

							hekurrudhore- Plazh", shpenzime operative dhe Punime riparimi ne puseten e komandimit rezervuari l'apana
00	Totali 1			30,948	-30,948	0	
00	09120	600	1	6,280	0	6,280	
00	09120	601	1	1,049	0	1,049	
00	09120	600	1	244	0	244	
00	09120	601	1	41	0	41	
00	09120	600	1	3,991	0	3,991	
00	09120	601	1	667	0	667	
00	09120	600	1	163	0	163	
00	09120	601	1	27	0	27	
00	09230	600	1	1,314	0	1,314	
00	09230	601	1	222	0	222	
00	04240	600.5	1	780	0	780	
00	04240	601	1	180	0	180	
00	03280	600	1	1,626	0	1,626	
00	03280	601	1	160	0	160	
00	04260	599.8	1	150	0	150	
00	04260	601	1	42	0	42	
00	01110	600	1	4,635	0	4,635	Fondi eshte alokuar nga buxheti I shtetit per efekt te rritjes se pagave
00	01110	601	1	1,800	0	1,800	
00	03140	600	1	2,400	0	2,400	
00	03140	601	1	401	0	401	
00	06140	600	1	595	0	595	
00	06140	601	1	100	0	100	
00	08220	600	1	1,500	0	1,500	
00	08220	601	1	264	0	264	
00	10430	600	1	2,300	0	2,300	
00	10430	601	1	384	0	384	
00	08130	600	1	555	0	555	
00	08130	601	1	99	0	99	
00	08130	600	1	176	0	176	
00	08130	601	1	32	0	32	
00	04520	600	1	3,000	0	3,000	
00	04520	601	1	530	0	530	
00	06260	600	1	1,800	0	1,800	
00	06260	601	1	301	0	301	
00	05100	600	1	1,500	0	1,500	

2

Nr.139
Dt.28.09.2023



	00	05100	601	1	360	0	360		
	00	10430	600	1	1,285	0	1,285		
	00	10430	601	1	216	0	216		
	00	08220	600	1	690	0	690		
	00	08220	601	1	116	0	116		
	00	Totali 2			41,975	0	41,975		
3	00	01110	602	1	127,690	0	127,690	Fond I alokuar per shlyerje te detyrimeve te prapambetura	Nr.186 Dt.22.12.2023
	00	Totali 3			127,690	0	127,690		
	00	TOTALI 1+2+3			200,613	-30,948	169,665		

Fondi rezervë i planifikuar për vitin 2023 ishte 25,000 mijë lekë dhe nuk është përdorur.

Fondi i kontigjences i planifikuar vitin 2023 ishte ne vlerën 15,000 mijë lekë dhe nuk është përdorur.

Fondi i emergjencave civile për vitin 2023 ishte planifikuar ne vlerën 35,000 mijë lekë në programin e mbrojtjes civile (kodi programit 03280) dhe nuk është përdorur.

Gjatë vitit 2023 Bashkisë në zbatim të ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile” iu alokua një fond prej 38,975,398 lekë. Realizimi financiar i tij është 28,504,278 lekë, me 74 përfitues. Ky fond është përdorur me vendime te vecanta të Këshillit Bashkiak si më poshtë:

Tabela 11: Përdorimi i fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile, viti 2023 (në 000/lekë)

Gr.	Program	Kap.	Kod produkti	Llog. ekon.	Fondi i detajuar sipas VKB	Realizimi financiar në lekë	Nr.perfitu esve faktike	NR. DHE DT. VKB	EMËRTIMI
17	10910	01	91707AB	604	32,950	22,670	66 nga 114 te planifikuar	VKB NR.147 DT 28.09.2023	Per miratimin e ndihmes financiare me vlere 32.950.500 leke per familjet e demtuara si pasoje e permbytjes nga rreshjet e shiut te dates 19.03.2018
17	10910	01	91707AB	604	4,647	4,647	7	VKB NR.165 DT 03.11.2023	Per miratimin e ndihmes financiare me vlere 4.646.922 leke per familjet, qe kane pesuar deme si pasoje e renies se zjarrit ne banesat e tyre



17	10910	01	91707AB	604	1,187	1,187	1	VKB NR.185 DT 22.12.2023	Per miratimin e ndihmes financiare me vlere 1.186.856 leke per familjet,qe kane pesuaar deme si pasoje e renies se zjarrit ne banesat e tyre
					38,784	28,504	74		

III. KARAKTERISTIKA KRYESORE TË PERFORMANCËS SË SHPENZIMEVE

Për vitin 2023 situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve nga të ardhurat dhe transfertat e pakushtëzuar dhe sektoriale krahasuar me buxhetin dhe planin e periudhës, paraqitet si më poshtë:

Tabela 12: Realizimi shpenzimeve nga të ardhurat dhe transfertat ne % , viti 2023

Gr.	P	Kodi	Emërtimi programit	Viti 2023	
				% e realizimit të kundrejt buxhetit	% e realizimit kundrejt planit të periudhës
00	P1	01110	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	77	78
00	P2	03140	Shërbimet e Policisë Vendore	92	93
00	P3	03280	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	44	58
00	P4	04130	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	5	13
00	P5	04220	Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorëve	0	0
00	P6	04240	Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit	87	97
00	P7	04260	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	45	45
00	P8	04520	Rrjeti rrugor	65	76
00	P9	04570	Transporti Publik	-	-
00	P10	05100	Menaxhimi Mbetjeve	94	95
00	P11	06140	Planifikimi Urban Vendor	32	44
00	P12	06260	Shërbimet Publike Vendore-	82	92
00	P13	06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime		
00	P14	07220	Shërbimet e Kujdesit Parësor	71	71
00	P15	08130	Sport dhe Argëtim	80	89
00	P16	08220	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore	91	95
00	P17	09120	Arsimi Bazë Përfshirë Parashkollorin	74	100
00	P18	09230	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	77	100
00	P19	10430	Përkujdesja Sociale	88	90
00	P20	10661	Strehimi Social	22	63
			TOTALI I SHPENZIMEVE	76	88



Pra siç shikohet nga të dhënat e tabelës së mësipërme plani i shpenzimeve nga të ardhurat dhe transfertat (grupi 00) për Bashkinë Durrës për vitin 2023 është realizuar në masën 76 %, kurse ai i periudhës është realizuar 88%. Krahasuar me vitin 2022 rezulton që realizimi i buxhetit të jetë rritur me 3% , kurse realizimi kundrejt planit të periudhës është rritur me rreth 2% krahasuar me vitin 2022. Për vitin 2023 programi me realizimin më të lartë të buxhetit është programi “Menaxhimi i mbetjeve” (kodi 05100) me 94%, kurse programi me realizimin më të ulët është programi “Mbështetja për zhvillimin ekonomik” (kodi 04130).

Pesha specifike e shpenzimeve faktike në vitin 2023 , jepet ne tabelën e mëposhtëme:

Tabela 13: Pesha specifike e shpenzimeve faktike ne %

Gr.	P	Kodi	Emërtimi programit	Pesha specifike
00	P1	01110	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	14.0
00	P2	03140	Shërbimet e Policisë Vendore	2.1
00	P3	03280	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	1.9
00	P4	04130	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	0.0
00	P5	04220	Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorëve	0.0
00	P6	04240	Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit	2.7
00	P7	04260	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	0.1
00	P8	04520	Rrjeti rrugor	10.9
00	P9	04570	Transporti Publik	0.0
00	P10	05100	Menaxhimi Mbetjeve	27.2
00	P11	06140	Planifikimi Urban Vendor	0.5
00	P12	06260	Shërbimet Publike Vendore-	11.3
00	P13	06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	0.0
00	P14	07220	Shërbimet e Kujdesit Parësor	0.3
00	P15	08130	Sport dhe Argëtim	3.4
00	P16	08220	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore	2.0
00	P17	09120	Arsimi Bazë Përfshirë Parashkollorin	16.0
00	P18	09230	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	2.9
00	P19	10430	Përkujdesja Sociale	3.7
00	P20	10661	Strehimi Social	1.0
TOTALI I SHPENZIMEVE				100

Duke parë strukturën e realizimit të shpenzimeve (grupi 00) për vitin 2023 , vërejmë që pjesën më të madhe të shpenzimeve faktike e zënë shpenzimet e programit “Menaxhimi i mbetjeve” me 27 % dhe programi “Arsimi bazë përfshirë parashkollorin me ” me 16 %, kurse programi me peshë specifike më të ulët është programi “Administrimi i pyjeve dhe kullotave” me 0,07% .

Shpenzimet faktike nga të ardhurat dhe transfertat e pakushtëzuar dhe sektorialet për vitin 2023 janë 3,547, 116 mijë lekë ose 8% më shumë se viti 2022. Sipas programeve buxhetore paraqiten në tabelën e mëposhtëme:

Tabela 14 : Shpenzimet faktike nga të ardhurat dhe transfertat e pakushtëzuar dhe sektoriale , 2022-2023 (000/lekë)

Gr.	P	Kodi	Emërtimi programit	Viti 2022	Viti 2023	Ndryshimi ne %
00	P1	01110	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	473,854	494,937	4.4
00	P2	03140	Shërbimet e Policisë Vendore	82,812	75,694	-8.6
00	P3	03280	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	72,816	65,892	-9.5
00	P4	04130	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	35,808	919	-97.4
00	P5	04220	Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorëve	-	-	
00	P6	04240	Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit	62,597	95,425	52.4
00	P7	04260	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	2,184	2,615	19.8
00	P8	04520	Rrjeti rrugor	329,858	387,723	17.5
00	P9	04570	Transporti Publik	-	-	
00	P10	05100	Menaxhimi Mbetjeve	964,074	965,717	0.2
00	P11	06140	Planifikimi Urban Vendor	14,900	17,100	14.8
00	P12	06260	Shërbimet Publike Vendore-	464,629	401,715	-13.5
00	P13	06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	-	-	
00	P14	07220	Shërbimet e Kujdesit Parësor	-	11,387	
00	P15	08130	Sport dhe Argëtim	83,648	121,973	45.8
00	P16	08220	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore	80,344	71,181	-11.4
00	P17	09120	Arsimi Bazë Përfshirë Parashkollorin	382,370	566,002	48.0
00	P18	09230	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	74,397	102,142	37.3
00	P19	10430	Përkujdesja Sociale	113,699	130,742	15.0
00	P20	10661	Strehimi Social	46,109	35,952	-22.0
			TOTALI I SHPENZIMEVE	3,284,100	3,547,116	8.0

Krahasuar me vitin 2022 vihet re që shpenzimet për programin “Arsimi Bazë Përfshirë Parashkollorin” kanë pësuar rritjen më të madhe me 48%.

Sipas zërave përberës të shpenzimeve, korrente e kapitale situata gjatë **vitit 2023**, paraqitet si me poshtë:

Shpenzimet korrente

Për vitin 2023 shpenzimet korrente (grupi 00) kapën vlerën 2,704,547 mijë lekë ose 3% më shumë se viti 2022. Për vitin 2023 shpenzimet korrente zënë **76% të shpenzimeve faktike**. Pra volumi i tyre është në zbritje me 4% krahasuar me vitin 2022 në të cilin zinin një peshë specifike prej 80%.. Realizimi kundrejt planit vjetor të buxhetit është 84% , kurse kundrejt planit të periudhës është 91%. Në mënyrë më të detajuar paraqiten në tabelën e mëposhtme :



Tabela 15 : Shpenzimet korrente viti 2023, (në 000/lekë)

Art.	Emërtimi	Fakti 2022	Buxhet filestar 2023	Buxhet i rishikuar 2023	Plan thesari 2023	Fakt 2023	Realizimi kundrejt buxhetit në%	Pesha specifi ke në %
600	Paga	1,099,610	1,272,960	1,387,243	1,352,504	1,260,254	90.8	36
601	Sig.shoqerore	183,069	210,860	227,325	224,873	209,370	92.1	6
602	Mallra dhe sherbime	1,248,926	1,169,256	1,325,433	1,280,883	1,118,006	84.4	32
603	Subvencione	0	0	0	0	0		0
604	Transferta korrente te brendshme	40,000	20,000	40,000	40,000	40,000	100.0	1
605	Transferta korrente te huaja	0	0	0	0	0		0
606	Tranf.per buxh.fam.&indi	66,780	210,510	210,510	86,285	76,917	36.5	2
	TOTALI	2,638,386	2,883,586	3,190,511	2,984,546	2,704,547	84.8	76

Shpenzimet e personelit për vitin 2023 janë në vlerën 1,469,624 mijë lekë ose 15% më të larta se viti 2022. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes së nivelit të pagave gjatë vitit 2023 për të gjithë punonjësit e Bashkisë dhe institucioneve të varësisë. Ato zënë 42 % të totalit të shpenzimeve faktike. Për nga madhësia renditen të parat. Realizimi i tyre gjatë vitit 2023 është në masen 90.8% kundrejt buxhetit.

Nr.total i punonjësve për vitin 2023 ishte 1,856 veta për 11 njësi shpenzuese. Arsyet e realizimit në këtë masë janë:

1. Mosplotësimi i vendeve vakante
2. Raportet e paafsisë për punë për periudhen mbi 2 javë të cilat paguhen nga sigurimet shoqërore.

Shpenzimet operative faktike për vitin 2023 janë 1,118,006 mijë lekë dhe zënë 32% të shpenzimeve totale. Krahasuar me vitin 2022 këto shpenzime janë ulur me 10 %.

Transfertat tek individët/buxhetet familjare faktike për vitin 2023 kapën vlerën 76,917 mijë lekë. Në këtë grup shpenzimesh përfshihet :

- Ndhima financiare për sëmundje, vdekje dhe dalje në pension në zbatim të VKM nr.493 dt. 06.07.2011 “Për disa ndryshime në VKM nr.929 dt.17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të vecantë” me një vlerë totale 4,553 mijë lekë. U trajtuan 85 individë



- Ndhurma financiare e alokuar nga Bashkia për familjet në nevojë që nuk përfitojnë nga skema e NE, me një fond prej 4,102 mijë lekë, nga i cili përfituan 95 familje .
- Shpërblimi për nxënësit ekselent të shkollave të mesme dhe 9 vjecare me vlerë 3,985 mijë lekë. Përfituan 96 nxënës, nga të cilët 75 nxënës të shkollave 9 vjecare dhe 21 nxënës të shkollave të mesme.
- Subvencionimi i qerasë për tërmetin në vlerë 6,642 mijë lekë. U kompensua pjesa e mbetur pa financuar nga fondi i buxhetit të shtetit për këtë qëllim.
- Trajtimi ushqimor i sportistëve dhe trajnerëve të tyre pranë Klubit të Shumësporteve me vlerë 57,635 mijë lekë. U trajtuan 138 sportiste dhe 35 trajnerë.

Shpenzimet kapitale

Për vitin 2023 shpenzimet kapitale faktike ishin në vlerën 842,569 mijë lekë ose 30% më shumë se viti 2022. Ato zënë 24% të shpenzimeve faktike dhe paraqiten si në tabelën e mëposhtëme:

Tabela 16 : Shpenzimet kapitale viti 2023, (në 000/lekë)

Art.	Emërtimi		Buxhet fillestar 2023	Buxhet i rishikuar 2023	Plan i çelur në thesar 2023	Fakt 2023	Realizimi kundrejt buxhetit në%	Pesha specifike në %
230	Kapitale të Patrupëzuara	14,699	47,000	72,095	25,095	24,756	34.3	1
231	Kapitale të Trupëzuara	631,016	974,619	1,377,141	1,030,474	817,813	59.4	23
232	Transferta Kapitale	0	0	0	0	0		
Shpenzime Kapitale me financim te brendshem			1,021,619	1,449,236	1,055,570	842,569	58.1	24
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0	0		
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0	0	0	0		
232	Transferta Kapitale	0	0	0	0	0		
Shpenzime Kapitale me financim te huaj		0	0	0	0	0		
Totali	Shpenzime Kapitale	645,714	1,021,619	1,449,236	1,055,570	842,569	58.1	24

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim nga të ardhurat e bashkisë dhe transfertat për vitin 2023, sipas programeve është si në tabelën mëposhtëme:



Tabela 17: Realizimi shpenzimeve kapitale (grupi 00) për cdo program , viti 2023

P	Kodi	Emërtimi programit	Viti 2023	
			% e realizimit të kundrejt buxhetit	% e realizimit kundrejt planit të periudhës
P1	01110	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	26	29
P2	03140	Shërbimet e Policisë Vendore	-	-
P3	03280	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	24	24
P4	04130	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	3	7
P5	04220	Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorëve	0	0
P6	04240	Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit	95	95
P7	04260	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	-	-
P8	04520	Rrjeti rrugor	56	69
P9	04570	Transporti Publik		
P10	05100	Menaxhimi Mbetjeve	99	100
P11	06140	Planifikimi Urban Vendor	5	9
P12	06260	Shërbimet Publike Vendore-	79	97
P13	06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	-	-
P14	07220	Shërbimet e Kujdesit Parësor	71	71
P15	08130	Sport dhe Argëtim	20	34
P16	08220	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore	36	95
P17	09120	Arsimi Bazë Përfshirë Parashkollorin	36	36
P18	09230	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	100	100
P19	10430	Përkujdesja Sociale	25	100
P20	10661	Strehimi Social	63	65
		TOTALI I SHPENZIMEVE	58	88

Realizimi financiar i buxhetit të planifikuar për investime për vitin 2023 është 58%. Gjatë vitit 2023 u lidhën 72 kontrata (45 objekte, 16 supervizime, 11 kolaudime) me një vlerë totale prej 961,985 mijë lekë (këtu nuk përfshihen kontratat nga Fondi i Rindërtimit) dhe janë financuar 56% e vlerës ose 525,498 mijë lekë. Pjesa e mbetur prej 436,487 mijë lekë do të financohen gjatë vitit 2024. Nga vitet e mëparshme janë trashëguar 75 kontrata (31 objekte, 22 supervizime, 22 kolaudime) për objektet në proces me vlerë totale 519,030 mijë lekë. Nga këto kontrata para 2023 ishin financuar 26% ose 134,925 mijë lekë, kurse gjatë vitit 2023 u financuan 56% e vlerës totale ose 286,541 mijë lekë. Nga këto kontrata mbeten për tu financuar edhe 97,565 mijë lekë, të cilat mbarten dhe do të financohen gjatë vitit 2024. Nga objektet e investimeve të planifikuara për vitin 2024 për 31 objekte nuk arriten të kryheshin procedurat e prokurimit.

Për investimet nga Fondi i Rindërtimit informacioni i detajuar është në Shtojcën : Fondi i Rindërtimit nga buxhetit i shtetit



IV. VETËVLERËSIMI FINANCIAR

Në zbatim të Udhëzimit nr.35, date 29.12.2023 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për NJVQV-te”, pika 33, më poshtë po ju paraqesim tabelat me detyrimet që Bashkia Durrës ka ndaj të tretëve: “Tabela për verifikimin e situatës financiare” (Aneksi 1) dhe “Treguesit fiskale të konsoliduar të NJVQV” (Aneksi 2),

Tabela 18: Aneksi 1 - Detyrimet ndaj të tretëve deri me 31 dhjetor 2023 (në 000/lekë)

NR.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
a.2	Tituj të emetuar			
a.3	Garanci për të tretë			
b	Hua afatshkurtër	0		
b.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
b.2	Tituj të emetuar			
b.3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	140,428		3.96%
Llog. Ekon.	Emërtimi			
4864100	Vendime Gjyqesore	73,469		
4864200	Det.Prap. Sherbime	6		
4864201	D.P.EneriElektirke			
4864300	Det.Prap.Mirembajtje			
4864400	Det.Prap. Investime	66,953		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra			
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronetime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
III	Totali (I+II)	140,428	3,547,116	3.96%

Këtu janë përfshirë edhe detyrimet e ish komunave me fonde nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit apo FZHR që arrijnë vlerën 36,370 mijë lekë. Në raportin e detyrimeve të prapambetura të gjeneruar nga sistemi informatik financiar i Thesarit kjo shumë është e përfshirë në detyrimet e prapambetura sepse është e regjistruar në grupin 00, pasi para vitit 2015 fondet e FZHR për njësitë vendore regjistroheshin në grupin 00.

Sikurse shihet nga tabela e mësipërme detyrimet e prapambetura janë në vlerën 140,428 mijë lekë ose 3,96 % e shpenzimeve të miratuara . Pra Bashkia Durrës është në një situatë normale të gjendjes financiare.

Në vlerën e detyrimeve të prapambetura sipas udhëzimit të Ministrisë së Financave , për efekt të verifikimit të situatës financiare nuk përfshihen detyrimet e prapambetura të faturave të objekteve nga Fondi i Rindërtimit. Detyrimet që kanë si burim financimi Fondin e Rindërtimit të buxhetit të shtetit kapin vlerën 169,487 mijë lekë. Këto janë detyrime që do të shlyhen brenda 4 mujorit të parë të vitit 2024, me fondet e rindërtimit që trashëgohen nga viti 2023.

Detyrimet e prapambetura për objekte të financuara nga FZHR të trashëguara nga ish komunat deri më 31 dhjetor 2023 vazhdojnë të mbeten të njëjta si në vitin 2021 dhe janë si në tabelën e mëposhtme. Këtu detyrime nuk janë shlyer sepse kanë mungesë dokumentacioni.

Tabela 19: Detyrimet me burim financimi FSHZH, FZHR (në 000/lekë)

Emertimi i projektit	Detyrimi i mbetur për financim nga FZHR, FSHZH
1. Rikonstruksion rruga Maminas – Shenpjeter (ish komuna Ishëm)	3,180
2. Rikonstruksion rruga Fortuzi ne fshatin Shkalle (loti I) (ish komuna Manëz)	31,641
3. Ndërtim i shkollës 9 vjecare Xhavzotaj (ish komuna Rrushbull)	1,549
Vlera Totale	36,370

Tabela 20 : Aneksi 2 - Treguesit Fiskalë të Konsoliduar për vitin 2023 (në 000/lekë)

Nr.	E M E R T I M I	Vlera për periudhën e raportimit (Fakt progresiv)	Vlera e Buxhetit vjetor (Plan)
		4 mujori III-te 2023	2023
I	Të ardhurat e Pushtetit Vendor	1,851,571	2,118,990
1	Taksat e veta vendore	816,647	965,500
a.	Taksa mbi pasurinë	331,375	500,000
b.	Biznesi i vogel	4,426	39,500
c.	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	369,440	310,000
d.	Taksa të tjera vendore	111,406	116,000
2	Të ardhura jotatimore	724,254	863,940
a.	Tarifat e shërbimeve publike	364,010	480,000

b.	Tarifa administrative	183,865	236,030
c.	Të tjera jo tatimore	176,380	147,910
3	Taksa të ndara	310,670	289,550
a.	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë	58,323	110,000
b.	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	174,943	155,000
c.	Renta minerare	21	50
d.	Tatim mbi të ardhurat personale	77,383	24,500
e.	Të tjera		
II	Shpenzime te Buxhetit Vendor	3,547,116	4,679,747
1	Shpenzime Korrente	2,704,547	3,230,512
a.	Paga dhe fond i veçantë për paga	1,260,254	1,387,243
b.	Kontributi për Sigurime Shoqërore	209,370	227,325
d.	Shpenzime Operative	1,118,006	1,325,433
e.	Të tjera korrente	116,917	290,510
2	Shpenzime Kapitale	842,569	1,449,235
3	Burimet e Financimit	3,547,116	4,679,747
a.	Të ardhurat e veta vendore	1,736,745	2,628,309
b.	Transferta e pakushtezuar	1,098,084	1,137,972
c.	Transferta specifike/transferta e pakushtezuar sektoriale	712,287	913,466
d.	Të ardhurat e pa-planifikuara (jashtë limit)		
f.	Financimi i huaj		
g.	Huamarrja Vendore Vjetore		

Tabela 21: Detyrimet e parapambetura sipas burimit të financimit për vitet 2017-2023 (në 000/lekë)

	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
te mbartura nga ish komunat	373,643	355,024	355,024	179,566	156,888	110,554	110,374
nga fondet e veta te Bashkive	138,992	43,744	24,512				30,054
nga fondet e buxhetit te shtetit			5,863	5,863			
nga fondi I rindertimit					124,063		169,487
totali	512,635	398,768	385,399	185,429	280,951	110,554	309,915

Shënim : Viti 2017 është viti i parë në të cilin ka filluar regjistrimi i detyrimeve të parapambetura.

Sikurse shihet nga tabela peshën specifike më të madhe të detyrimeve e zënë ato të trashëguara nga ish komunat.. Bashkia Durrës është kujdesur që të shlyejë vit mbas viti detyrimet e trashëguara nga komunat . Kështu kahasar me vitin fillestar vlera e këtyre detyrimeve në fund të vitit 2023 rezulton e pakësuar me 70%. Vlera e mbetur e papaguar e detyrimeve të trashëguara nga ish komunat ka mbetur për arsye mungese dokumentacioni. Detyrimet e krijuara rishtazi gjate vitit 2023 janë detyrime të kontratave të projekteve të rindertimit . Moslikujdimi i faturave nuk ka ndodhur për mungese fondesh, por për arsye teknike, si mungesë dokumentacioni apo probleme regjistrimi në sistemin SIFQ të pagesave . Viti 2023 ishte viti i parë që Bashkia Durrës operoi online në Sistemin Informatij Financiar te Qeverisë (SIFQ), gjë e cila është shoqëruar edhe me problematikat e veta , të cilat janë zgjidhur hap pas hapi. Këto detyrime brenda muajit mars shlyhen plotsisht.

Plani i shlyerjes së detyrimeve për vitet 2024-2026 paraqitet si në tabelën e mëposhtëme:

Tabela 22 : Plani i shlyerjes së detyrimeve të parapambetura për vitet 2023-2025 (në 000/lekë)

Nr.	Bashkia	Detyrimi i mbetur deri në 31 dhjetor 2023	Shuma e parashikuar për shlyerje përgjatë viteve			Diferenca (plan-fakt)
			Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	
	Bashkia Durrës	309,915	271,986	28,040	9,889	0

V. TREGUESIT FINANCIAR

Tabela 23 : Treguesit financiar 2019-2023

		2019	2020	2021	2022	2023
1	Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave	83.3%	83.8%	74.7%	83.2%	80%
2	Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore ndaj totalit të të ardhurave	29.2%	28.7%	37.8%	39%	41%
3	Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave	39.2 %	38.1%	56%	55%	54%
4	Norma e shpenzimeve kapitale ndaj totalit të shpenzimeve	36.6 %	27.0 %	22 %	19.7%	24%
5	Norma e shpenzimeve korrente ndaj shpenzimeve totale	63.4%	73.0 %	78 %	80.3%	76%
6	Norma e shpenzimeve të personelit ndaj totalit të shpenzimeve	39.5 %	47.2 %	48 %	39%	41%
7	Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj totalit të të ardhurave	-	-	-	-	-
8	Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj të ardhurave të veta	-	-	-	-	-
9	Norma e detyrimeve të parapambetura ndaj totalit të të ardhurave		4.21%	3.34%	2.01%	3.96%



10	Norma e shpenzimeve në politikat sociale ndaj totalit të shpenzimeve	4.7%	4.8%	6%	4.8%	4.7%
----	--	------	------	----	------	------

Shënim: Në këtë tabelë re zutatet i referohen vetem fondeve nga te ardhurat dhe transfertat e pakushtezuar dhe sektoriale (nuk jane te perfshira fondet e rindertimit dhe ML)



SHTOJCA 1: FONDI I RINDËRTIMIT NGA BUXHETI I SHTETIT

Gjaë vitit 2023 janë marrë 3 Vendime të Keshillit të Ministrave për alokim fondesh për Bashkinë Durrës për procesin e rindërtimit për financimin e mëtejshëm të objekteve të rindërtimit në proces me një vlerë totale prej 3,598,765 mijë lekë dhe paraqiten si në tabelën e mëposhtme :

Tabela 24: VKM-te e vitit 2023 për financimin e projekteve të rindërtimit në vazhdim nga vitet e kaluara

Nr.	VKM qe ka miratuar fondin	Emertimi i fondit	Fondi sipas VKM në lekë
		I. FINANCIM PROJEKTESH NE VAZHDIM	
1	NR. 506 DATE 30.08.2023	Rehabilitimi i infrastruktures se rrjetit te kullimit ne zonen e Porto Romanos-kenete dhe sistemimin e ujrave te shiut ne zonen urbane te qytetit te Durrës	892,511,313
2	NR.690 DATE 06.12.2023	Financimi i rforcimit te njesive individuale te banimit dhe njesive te banimit ne ndertesa (pallat) (49 pallate +1 njesi individuale, jane ndare ne 5 lote)	1,490,187,768
3	NR.682 DATE 06.12.2023	Riforcimit te njesive individuale te banimit dhe njesive te banimit ne ndertesa (pallat) ne Bashkine Durrës (19 pallate + 62 njesi individuale, jane ndare ne 4 lote)	1,216,066,129
		TOTALI 1	3,598,765,210

Plani i fondeve të Rindërtimit për vitin 2023 duke përfshirë edhe fondet e mbartura nga viti 2022 prej 907,173 mijë lekë arriti në vlerën 4,505,938 mijë lekë dhe nga këto fonde janë disbursuar 2,692,199 mijë lekë ose 59.7% e planit. Ky mosrealizim ka ardhur për mungesë fondesh gjatë vitit duke sjell vonesa në realizimin e kontratave .Fondet për financimin e mëtejshëm të këtyre objekteve u alokuan nga buxheti i shtetit ne dhjetor sipas VKM-ve që i renditëm më sipër. Fondet e papërdorura prej 1,813,740 mijë lekë trashëgohen për vitin 2024 me të njëjtin destinacion.

Në mënyre të përmbledhur fondi i rindërtimit sipas produkteve dhe VKM –ve përkatëse paraqitet si në tabelat e mëposhtme:

FONDET E RINDËRTIMIT SIPAS PRODUKTEVE

Tabela 25 : Aktrakordimi me Thesarin për Fondet e rindërtimit për cdo produkt dhe artikull, viti 2023 (në lekë)

